

## KONTRATE SHITJE KUOTE

Sot, më datë 14.10.2021, ditë e enjte, ne palët kontraktore vendosëm në vullnetin tonë të lirë të përpilojmë këtë kontratë SHITJE mbi kuotën së shoqërisë **“Go. Break Sh. P.K.**, regjistruar në Shqipëri, në QKB më datë 12.12.2018, me numër unik të identifikimit të subjektit (NUIS) L82412505E, me seli në Durrës, Xhafzotaj, objekt me nr.pasurie 158/282-ND, zone kadastrale 2574, si me poshte vijon:

### Subjektet:

#### Shitësi:

1. **Z. Landi Konomi**, lindur në Durrës me 02-09-1970, identifikuar me dokumentin leternjoftim nr. 036029783, leshuar me date 20-05-2020, date skadimi H00902056M; me profesion “Teknik”, identifikuar në regjistrat e Gjendjes Civile në Republikën e Shqipërisë me nr.personal \_\_\_\_\_; zotërues i 100 % te kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë shoqërisë “Go. Break Sh. P.K.

#### Blerësit:

1. **Theofan Kazanxhiu**, atësia Jorgji, amësia Krisanthi, shtetas Shqiptar, lindur në Durrës dhe banues në DURRËS, me adresë Hajdar Demiri 00690300; Nd. 3; H. 11; Ap. 28; Durrës; Durrës; 2003; Durrës, lindur më 15/06/1978, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar në regjistrat e Gjendjes Civile në Republikën e Shqipërisë me nr. personal H80615077G;

**Objekti dhe qëllimi i kontratës:** Kalimi i pronësisë mbi 100 % të kuotës që disponon z. Landi Konomi si ortak i vetëm në shoqërinë **“Go. Break Sh. P.K.**, në favor të blerësit z. Theofan Kazanxhiu, si më poshtë:

1. Kuota është në 100 %, në pronësi të z. **Landi Konomi**, do t'i shitet në vlerën prej **10.000 lekë** (dhjetëmijë) **z. Theofan Kazanxhiu**.

Për shkak të shitjes kapitali i shoqërisë do të përbëhet nga një kuotë e vetme dhe konkretisht:

- 1) **z. Theofan Kazanxhiu**, behet ortak i vetem dhe zotërues i një (1) kuote që përkon me 100 % të kapitalit themeltar, me vlerë të përgjithshme: 10.000 (dhjetëmijë) lekë.

#### Baza ligjore:

Neni 761 e vijues i Kodit Civil te Republikes se Shqiperise;  
Ligji nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;  
Aktet nenligjore ne zbatim.

**Shitësi Landi Konomi, në cilësinë e ortakut të vetë të shoqërisë “Go. Break Sh. P.K.**, me nënshkrimin e kësaj kontrate, konfirmon se në cilësinë e pronarit/shitësit të kuotës objekt kontrate, shfaq vullnetin e tij të lirë dhe të plotë që pronësia mbi kuotën që përkon me 100 % të kapitalit të shoqërisë **“Go. Break Sh. P.K., të kalojë në favor të z. Theofan Kazanxhiu**, dhe për rrjedhojë edhe pronësia mbi shoqërinë dhe të gjitha të drejtat e shoqërisë, mbi të gjitha asetet e saj dhe pasuritë në pronësi të shoqërisë **Go. Break Sh. P.K** t'i kalojnë *(t'ia shesë)*



*porpocionalisht me kuotën objekt i kesaj kontrate në mënyrë përfundimtare si më poshtë vijon:*

1. Kuota në masën 100 %, do t'i shitet për vlerën **10.000 lekë (dhjetëmijë) z. Theofan Kazanxhiu.**

Me nënshkrimin e kesaj kontrate pala shitëse zhvishet në mënyrë përfundimtare nga të drejtat e pronësisë mbi kuotën e cila ërkon me vlerën 100 % të kapitalit themeltar objekt i kesaj kontrate.

**Blerësi, z. Theofan Kazanxhiu,** në cilësinë e blerësit të kuotës objekt i kesaj kontrate, me nënshkrimin e kesaj kontrate shfaq vullnetin e tij të lirë dhe të plotë **për të fituar pronësinë** mbi kuotën që përkon me 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë, siç është përcaktuar në këtë kontratë, të shoqërisë **Go. Break Sh. P.K..** Së bashku me të drejtat që u pershkruan më sipër blerësi me nënshkrimin e kesaj kontrate konfirmon se pranon të marrë përsipër të gjitha detyrimet e shoqërisë **Go. Break Sh. P.K.,** siç janë në datën e sotme. Me nënshkrimin e kesaj kontrate pala blerëse fiton në mënyrë përfundimtare të gjitha të drejtat mbi shoqërinë *porpocionalisht me kuotën objekt i kesaj kontrate dhe në këtë mënyrë, për shkak të kesaj kontrate kapitali themeltar i shoqërisë Go. Break Sh. P.K., do të shpërndahet në pronësi të ortakut të vetëm si më poshtë:*

Palet kanë rënë dakord që pronësia që do të krijohet në shoqërinë si pasojë e kesaj kontrate do pasqyrohet si më poshtë vijon:

Kapitali themeltar i shoqërisë **Go. Break Sh. P.K.,** do të jetë 10.000 (dhjetëmijë) lekë.

Ky kapital do të ndahet në një (1) kuotë.

Pjesëmarrja e ortakëve në kapitalin e shoqërisë do të shpërndahet si më poshtë:

1. **Theofan Kazanxhiu,** zotërues i një (1) kuote që përkon me 100 % të kapitalit themeltar, me vlerë të përgjithshme: 10.000 Leke;
2. Për rrjedhojë, **z. Theofan Kazanxhiu do të jetë ortak i vetëm i Shoqërisë Go. Break Sh. P.K.,**

Palët, deklarojnë në vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë se kjo kontratë është hartuar dhe nënshkruar prej tyre duke qenë të vetëdijshëm me pasojat dhe efektet juridike që krijon ky veprim juridik.

Kjo marrëdhënie juridike do të rregullohet bazuar në legjislacionin shqiptar.

Kontrata u hartua ne 3 kopje origjinale dhe do të regjistrohet në regjistrat përkatës në zbatim të legjislacionit mbi të cilin zhvillohet kjo marrëdhënie juridike.

### PALËT KONTRAKTORE

#### SHITËSI

1. **Landi Konomi**

Ortak i vetem i shoqerise **Go. Break Sh. P.K**

*Landi Konomi*

*[Signature]*



#### BLERËSI

1. **Theofan Kazanxhiu**

*THEOFAN KAZANXHIU*

*[Signature]*